



Pranuar / Doretuar Pimlëno/Prodato Received/Delivery	07.03.2023	viti god year	3
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMESH/CK	3022/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.416/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.416/2023 të datës 24.02.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga "Tringë Ismaili", në Prishtinë, kundër Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës respektivisht kunder mos vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.416/2023 e datës 24.02.2023 e parashtruar nga ankuesja
- II. Detyrohet Udhëheqës i Divizionit për Integritete Evropiane në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si mbikëqyrës i drejtpërdrejt i ankueses, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit, duke bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen nga muaji gusht deri në muajin dhjetor të vitit 2022 në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që të kujdeset që zbatimi i këtij vendimi të bëhet si në pikën II.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Ndaj ankueses e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 22.03.2016 në pozitën „Zyrtare për Integritet Evropianë” në kuadër të Divizionit për Integritet Evropianë në Ministrinë e Infrastrukturës tani Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nuk është bërë vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022 nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt. Ankuesja më datë 31.01.2023, 14.02.2023 dhe 22.02.2023 përmes emailit ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm, Drejtoreshën e Departamentit të Integriteteve Evropiane dhe Udhëheqësin e Divizionit të Burimeve Njerëzore të kësaj ministrie se udhëheqësja e drejtpërdrejtë nuk ka përmbushur obligimin ligjor sepse nuk ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë.

Ankuesja më datë 24.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2049/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes të cilët pretendon që të obligohet udhëheqësi i drejtpërdrejt të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.03.2023 ka proceduar kërkesën e ankuesit për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ndërsa Këshilli, me datë 17.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2049/2023 të datës 24.02.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 22.02.2023 nga ankuesja për S.S dhe L.O; Emailin e datës 14.02.2023 nga ankuesja për S.S, Emailin e datës 31.01.2023 nga ankuesja për S.S dhe H.Zh; Letër Rekomandim; Çërrfaten dhjetor 2022 për ankuesen; Emailin nga Ekipi i Gov4SAA; Emailin e datës 28.11.2022, 01.12.2022, 15.12.2022 nga V.A; Emailin e datës 09.12.2022 nga ankuesja për S.S; Emailin e datës 08.12.2022 nga Gov4SAA për V.A; Emailin e datës 12.07.2022, 15.06.2022 nga V.A; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 për ankuesen i datës 18.12.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 për ankuesen dhjetor 2021; Certifikatën për ankuesen maj 2010; Certifikatën për periudhë maj-korrik 2009; Certifikatën qershor 2017; Certifikatën 22.12.2009; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.03.2023; Akt Emërimit e ankueses i datës 22.03.2016; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen i datës 23.12.2019; Emailin e datës 13.03.2022 nga V.S për V.B; Emailin e datës 20.03.2023 nga V.S për A.B; Emailin e datës 17.03.2023 nga A.B për V.S; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për periudhën janar-korrik 2022; Akt Emërimit AE.Nr.DIEKP/4/2022 i datës 10.10.2023 për V.B; Emailin e datës 27.02.2023, 24.02.2023 nga V.B për H.Zh; Emailin e datës 27.02.2023, 24.02.2023, 23.02.2023 nga H.Zh për V.B; Emailin e datës 23.02.2023 nga H.Zh për L.O; Emailin e datës 23.02.2023 nga L.O për H.Zh.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të çështjes, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është pjesërisht e bazuar, *sepse*:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se përkundër obligimit ligjor të përcaktuar me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, nuk është bërë vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022 nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.

Duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon që nuk është vlerësuar në vitin 2022, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas provave të lëndës mbikëqyrës i drejtpërdrejt i ankueses nga muaji janar deri në muajin korrik ka qenë _____, i cili ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për periudhën janar-korrik 2022 duke e vlerësuar ankuesen me notën e përgjithshme 4.9, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit vlerëson se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses me rastin e vlerësimit të ankueses për periudhën janar-korrik 2022 ka vepruar në pajtim me nenin 43 paragrafin 1, 2, 3, 4, 6, 7 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: "Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuara në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njesisë apo institucionit. 3. Objektivat përcaktohen me shkrim, në fillim të vitit, në muajin janar, së bashku me planin e veprimtarive për arritjen e objektivave. 4. Objektivat përcaktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me nëpunësin dhe e bëjnë me dije atë.. 6. Gjatë periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë zhvillon takime me nëpunësin që vlerësohet, për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuara për të shprehur mendime dhe për të dhënë sugjerime, si dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim. 7. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë harton një raport vlerësimi. 8. Raporti i jepet punonjësit dhe ai diskutohet në një intervistë me të. 9. Pas intervistës, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë miraton raportin përfundimtar të vlerësimit", nenin 5 paragrafi 1, nenin 6 paragrafi 1 dhe nenin 7 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se: "neni 5. Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuara; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar). neni 6 paragrafi 1 : Brenda muajit Janar të vitit për të cilin bëhet vlerësimi i rezultateve në punë apo brenda tre (3) muajve të parë të emërimit të nëpunësit, mbikëqyrësi (vlerësuesi) së bashku me nëpunësin (i vlerësuar) përcaktojnë dhe pajtohen me objektivat dhe me planin e aktiviteteve për arritjen e objektivave të përcaktuara për vitin për të cilin vlerësohet, dhe neni 7: Mbikëqyrësi, së paku një herë gjatë periudhës vlerësuese dhe/ose sa herë që vlerëson të nevojshme, zhvillon takime me nëpunësin për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuara dhe sjelljet profesionale si dhe për dhënien e sugjerime për përmirësimet e nevojshme, kështu që për periudhën janar-korrik 2022 është bërë vlerësimi dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses për këtë periudhë ka plotësuar kërkesat ligjore.

Lidhur me vlerësimin e rezultateve ne punë për ankuesen për periudhën gusht-dhjetor 2022, Kolegji i Këshillit, në bazë të provave të lëndës, konstaton se ky vlerësim nuk është bërë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, rrjedhimisht në bazë të provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se sipas Vendimit me numër protokolli 5489 të datës 02.08.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nëpunësja znj. [redacted] është transferuar në pozitën „Udhëheqës i Divizionit për Integritimeve Evropiane” i cili vendim ka qenë i vlefshëm deri më datë 31.10.2022 kur me Vendimin A.nr.752/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërimin Civil të Kosovës është shfuqizuar për shkak të nxjerrjes së këtij vendimi nga organi jo kompetent dhe në të njëjtën kohë është obliguar Njësia e Burimeve Njerëzore e kësaj ministrie të bëjë rishqyrtimin e këtij rasti, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës më datë 17.11.2022 ka nxjerr Vendim me numër protokolli 7900 përmes të cilit znj. [redacted] transferohet në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Integritimeve Evropiane, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se nga muaji gusht i vitit 2022 si udhëheqës i drejtpërdrejt i ankueses është znj. [redacted].

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se Zëvendësuesja e Drejtorit të Departamentit për Integritim Evropian dhe Koordinim të Politikave znj. [redacted] përmes emailit të datës 24.02.2023 ka kërkuar nga znj. [redacted] që vlerësimi për ankuesin të takon si mbikëqyrës e drejtpërdrejtë, ndërsa znj. [redacted] Bllaca përmes emailit të datës 27.02.2022 të dërguar znj. [redacted], ka theksuar që në këtë rast ankuesja nuk ka raportuar tek Udhëheqës i Divizionit për Integritimeve Evropiane por ka raportuar tek ju. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, vlerëson se znj. [redacted] nga momenti kur është transferuar në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Integritimeve Evropiane, nuk ka ndonjë dëshmi që të ketë kërkuar nga ankuesja që e njëjta t’i raportoj asaj dhe nuk ka ndërmarr ndonjë veprime tjetër juridike lidhur me shqyrtimin e përmbushjes së objektivave në kuadër të këtij divizionit që ndërlihet me pozitën edhe të ankueses.

Meqenëse nga muaji gusht i vitit 2022 ankuesit i është ndërruar mbikëqyrësi i drejtpërdrejt, atëherë sipas nenit 43 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë, është përcaktuar se: *“Nëpunësi civil vlerësohet nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse”,* ndërsa e njëjta është paraparë edhe me nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, i cili ka përcaktuar se: *“Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimit vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues”,* atëherë bazuar në këtë Kolegji i Këshillit, konstaton se znj. [redacted] ka pasur obligim ligjorë në kuptim të dispozitave të lartcekura të bëjë vlerësimin e rezultateve ne punë për ankuesen për periudhën gusht-dhjetor 2022, kështu që pretendimi i ankueses për këtë pjesë është i bazuar.

Nga të lartcekurat, Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh dispozitat ligjore në fuqi dhe duke marr parasysh gjendjen faktike, konstaton se vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civil është obligim ligjor, rrjedhimisht Udhëheqësi i Divizionit për Integritet Evropian në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të parapara me nenin 43 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrat Publike dhe dispozitave të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, është i obliguar që të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për periudhën gusht-dhjetor 2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.416/2023

Avdyll BEKTESHI

Be ktashi
Procesmbajtës

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Malsore Gashi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Divizionit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.